LIGJ
Nr.9897, datë 10.4.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9640, DATË 9.11.2006 "PËR DHOMAT E TREGTISË DHE INDUSTRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.9640, datë 9.11.2006 "Për dhomat e tregtisë dhe industrisë", neni 6 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 6
Anëtarësia

Anëtarësia në dhomë është vullnetare për personat juridikë dhe fizikë, të regjistruar në regjistrin tregtar, sipas legjislacionit në fuqi.

Anëtarët e dhomës paguajnë kuotën vjetore të anëtarësisë. Masa dhe procedurat e vjeljes së kuotës përcaktohen nga asambleja e dhomës.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5689, datë 29.4.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi